



Pranimar / Doretuar Prilipenar/Prudato Received/Delivered	30.03.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org. Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicana Quantity
SKPMSTHCK	3143/2023		113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.380/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.380/2023 të datës 21.02.2023 të parashtruar nga ankuesi _____, nga Mitrovica e Jugut, kundër organit të punësimit/Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 29.03.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.380/2023 e datës 21.02.2023, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Nëpunësi civil _____ i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, më datë 21.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1950/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me shkrim të datës 16.02.2023 të Zyrës së Personelit në Komunën e Mitrovicës së Jugut, lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit për kompensim në mënyrë retroaktive të mjeteve të paguara në emër të diferencës së koeficienti të pagës nga gjashtë (6) në tetë (8) nga hyrja në fuqi e ligjeve të miratuara nga institucionet e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 23.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Ndërsa Këshilli, me datë 15.03.2023 përmes e-malit ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 380/2023 të datës 21.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën me numër të referencës 01-120/08-0012877/23 të datës 15.02.2023 të parashtruar nga ankuesi te organi i punësimit; Përgjigje në kërkesë me numër të referencës 01-120/04-0012877-2/23 të datës 16.02.2023 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 2024/2023 të datës 23.02.2023; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 2667/2023 të datës 15.03.2023; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 21.09.2012; Listën e pagave për muajin Janar-2023; Listën e pagave për muajin Shkurt-2023; Akt Emërimit me numër protokollit 01-112-7604 të datës 28.02.2013.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut në pozitën e punës *Inspektor i Tregut*. I njëjti më datë 07.10.2022 kishte parashtruar ankesë për harmonizimin e koeficientit të pagës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.874/2022 të datës 21.11.2022 ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar dhe ka obliguar organin e punësimit që ankuesit t'ia harmonizoj koeficientin e pagës me titullin e pozitës dhe përshkrimin e vendit të punës, nga koeficienti gjashtë (6) në tetë (8), ku si rrjedhojë organi i punësimit, respektivisht Komuna e Mitrovicës së Jugut, më datë 30.11.2022 ankuesit i ka lëshuar Akt Emërimit AE.Nr.01-112/01-0106446/22 me koeficient tetë (8) të pagës.

Ankuesi më datë 15.02.2022 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut për kompensimin retroaktiv të diferencës së koeficientit për periudhën nga marsi 2013 e tutje. Ndërsa, Udhëheqësi i Personelit përmes përgjigjes së datës 16.02.2023 ka refuzuar kërkesën e ankuesit me arsyetimin se koeficienti i pagës tetë (8) do të vlejë vetëm nga data e zbatimit të vendimit të Këshillit.

I pakënaqur me përgjigjen e datës 16.02.2023 të organit të punësimit, ankuesi me datë 21.02.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, po me bazë të njëjtë gjegjësisht për njohjen e të drejtës për kompensimin retroaktiv të diferencës së koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në tetë (8) për periudhën nga marsi 2013 e tutje.

Kolegji i Këshillit, shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedhë së ankuesi me datë 26.03.2013 ka nënshkruar pa vërejtje aktin e emërimit për pozitën e punës "*Inspektor i tregut*" me koeficient të pagës gjashtë (6), dhe se i njëjti edhe përkundër faktit se ka qenë në dijeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri me datë 07.10.2022, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohën kur ankuesi kishte nënshkruar aktin e emërimit me datë 14.02.2013), përkatësisht nenin 130 të këtij ligji ku përcaktohej se: 130.1. *Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.*



Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm nuund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.380/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së